FEDERATA E GJIMNASTIKËS E KOSOVËS
KOSOVA GYMNASTIC FEDERATION

KUVENDI I PUNËS I FEDERATËS SË GJIMNASTIKËS TË KOSOVËS

PROCEVERBALI

Me datë 18 Prill 2026, në ora 12:10 është mbajtur Kuvendi i Punës së Federatës së Gjimnastikës të Kosovës,(FGJK), në hapësirat e Fakultetit të Edukimit Fizik dhe Sportit në Prishtinë.
Kuvendi është thirrur nga Bordi Ekzekutiv i FGJK-së, njoftimi, formulari për delegatë dhe dokumentacioni i Kuvendit janë dërguar me kohë, tek 15 klubet gjimnastikore të licensuara në përputhje me dispozitat statutore në fuqi. Nga 15 klube të licensuara të FGJK-së, 8 klube janë përgjigj pozitivisht dhe kanë dërguar formularin e plotësuar me emrat të delegatëve të tyre, pranë sekretariatit të FGJK-së, duke respektuar afatet statutore të FGJK-së.

- **ECURIA E KUVENDIT:**

Kuvendi i punës i FGJK-së i datës 18/04/2026, filloj në ora 12:10, në hapësirat e Fakultetit të Edukimit Fizik dhe Sportit.
Përveç delegatëve të kuvendit të FGJK-së, prezent ishin edhe monitorus nga MSR, Z. Fatlum Grajqevci, kurse nga KOK ishte Z. Avni Nuha.
Kuvendin e hapi Kryetari i FGJK-së, Z. Shkumbin Maqastena, duke ju referuar rendit të ditës si më poshtë:

1. **Hapja e mbledhjes nga ana e Kreytarit të FGJK-së**: Mbledhjen e hapi **Z. Shkumbin Maqastena** Kryetar i FGJK-së, ku përshëndeti anëtarët e Kuvendit si dhe të pranishmit tjerë, ku ndër të tjera thekësoi që në Sekretariatin e FGJK-së kemi pranuar email nga Klubi i Gjimastikës OMNISPORT të cilët kanë dërguar tre emera të delegatëve të tyre pa plotësuar formularin e dërguar nga FGJK për delegat të Klubeve, 3 ditë para mbajtjes së Kuvendit. Prezent janë vëtëm dy (2) anëtar dhe Z. Maqastena propozon që këta anëtar të pranohen edhe pse emrat e tyre janë dërguar më vonesë, të gjithë të pranishmit votuan PËR, nuk kishte kundër apo abstenime.

2. **Zgjedhja e një proces mbajtësi**: në këtë pikë Z. Maqastena propozoi që proces-mbajtës të jetë Znj. Elfete Gashi, dhe pasi që nuk kishte propozime tjera i njejti u hodh në votim ku anëtarët e Kunvendit unanimisht votuan më anë të aklamacionit që proces mbajtës gjatë Kuvendit të Punës të FGJK-së të jetë, **Znj. Elfete Gashi**.
3. **Zgjedhja e Komisionit verifikues prej 3 anëtarëve:** Për zgjedhje në komisionit u propozuan 3 anëtarë e ata janë:

    1. **Vlora Humolli Jashanica – Kryetare i Komisionit verifikues,**
    2. **Fatlind Qerimi – Anëtar i Komisionit verifikues,**
    3. **Lisa Zeqiri – Anëtare e Komisionit verifikues.**

Të tre anëtarët e propozuar u zgjodhën në mënyre unanime nga të gjithë të pranishmit sa edhe ishin prezent në Kuvend, sipas Komisionit verifikues pas leximit të emrave të çdo anëtari veç e veç dhe

FGJK – KGF
Shtëpia e Sporteve, Rruga Agim Ramadani, 10000 Prishtinë, tel:044/145/009 email:
kosovagymnasticsfederation@gmail.com

konfirmimin nga ana e tyre, në Kuvend të pranishëm ishin 26 anëtarë, duke përfshi edhe 2 anëtarët e OMNISPORTIT, me të drejtë vote, nga klubet e licensuara në FGJK, dhe u konstatua se kishte kuorum për vazhdimin e mbledhjes,

Anëtarët me të drejtë vote duke u bazuar në statutin e FGJK neni 17 numri dhe përcaktimi i delegatëve përcaktohet si më poshtë:

a. ***Çdo shoqatë apo klub sportivë ka 3 (tre) delegat.***
b. ***Çdo delegat ka të drejtën e 1 (një) vote.***

Anëtarët e Komisionit verifikues konstatuan që kishte korum për vazhdimin e kuvendit. Nga 15 klube të licensuara ka 3 anëtar totali është 45 anëtar, kurse në Kuvend prezent ishin 8 klube ka 3 anëtar kurse një klub kishte vetëm 2 anëtarë e që në total prezent ishin 26 anëtar me të drejtë vote.

Komisioni gjithashtu shpërndau listën me emra të anëtarëve të Kuvendit për nënshkrim,

Anëtarët prezent ishin nga këto Klube të licensuara:

1. Akademia e Gjimnastikës ”ARDHMËRIA”,
2. Akademia e Gjimnastikës ”UNIVERSITETI”,
3. Klubi i Gjimnastikës ”ELITA”,
4. Klubi i Gjimnastikës ”VUSHTRRIA”,
5. Klubi i Gjimnastikës ”FUSHË KOSOVË”,
6. Klubi i Gjimnastikës ”LIPJAN”,
7. Klubi i Gjimnastikës SKENDERAJ”,
8. Klubi i Gjimnastikës Ritmike ”POISE”.
9. Klubi i Gjimnastikës ”OMNISPORT”.

4. **Aprovimi i Proces Verbalit të Kuvendit të Jashtëzakonshëm të datës 19/03/2025** – Pas diskutimeve, proces verbali kërkohet të votohet nga të pranishmit ku 24 anëtar votuan PËR, nuk kishte kundër dhe as abstenim, vlenë të ceket që dy anëtaret e OMNISPORTIT nuk votuan as PËR, as Kundër as Abstenim. Procesverbali i është dërguar anëtarëve të Kuvendit, MSR, dhe KOK me kohë.
5. **Propizim ndryshim i Statutit të FGJK-së,** Sekretati i FGJK-së njoftoj të pranishmit se i tërë materiali i është dërguar anëtarëve të Kuvendit, MSR, dhe KOK me kohë, dhe se bazuar në statut çdo anëtar ka pas mundësi të jep komentet apo të propozoj futjen e ndonjë pike në rend të ditës, një gjë e tillë nuk ndodhur. Në këtë pike kishtë shumë kundërshtim nga ana e anëtarës së OMNISPORTIT, Mimoza Osmani e cila shprehet se statuti dhe rregulloret që janë dërguar më ndryshime, nuk janë të kuptueshme dhe se propozon që statuti dhe rregulloret gjegjësisht pika 5.6.7 të tejkalohen, statuti dhe rregulloret të dërgohen edhe njëherë tek anëtarët e Kuvendit të analizohen e pastaj të thirret një Kuvend tjetër për Statut dhe Rregullore dhe aprovimi i tyre. Sekretari i FGJK-së, njoftoj të pranishmit se draft statuti dhe statuti origjinal (i vjetri) janë dërguar më kohë tek të pranishmit dhe se të gjithë keni pasë mundësin që të paraqitni komentet e juaja, gje që ska ndodhur, mirëpo ai ceku se nësë është nevoja do t’i paraqesë të gjitha ndyshimet një nga një dhe të votohen, gjë të cilën filloj të e bejë,

FGJK – KGF
Shtëpia e Sporteve, Rruga Agim Ramadani, 10000 Prishtinë, tel:044/145/009 email:
kosovagymnasticsfederation@gmail.com

mirëpo kishte kundërshitm të madh nga anëtarja e OMNISPORTIT, duke theksuar se dokumentacioni nuk është i kjartë për të, dmth (kërkon që ndryshimet të jenë të theksuara me ngjyrë tjetër).

Sekretari i FGJK-së, spejgoi të pranishmëve për ndyshimet një nga një:

- Kreu I, Neni 8, paragrafi 4. Kuvendi me shumicën e votave të anëtarëve prezent 50% + 1 (është shtuar vetëm 50%+1) me të drejtë vote merr vendim për rekomandimet e Bordit Ekzekutiv për regjistrime.
- Kreu II, Neni 10, paragrafi 2. Një anëtari të cilit për ndonjë arsyetim të pranuar nga Kuvendi i është dhënë afate për shtyrjen e pagesës së anëtarësisë dhe i cili nuk ka kthyer pagesat apo borxhet e mbetura ndaj FGJK-së sipas afatit të caktuar nga Kuvendi do të pezullohet automatikisht nga e drejta e votës dhe pjesëmarrjes në gara të FGJK-së. Para hyrjes ne fuqi te pezullimit, anetari duhet te njoftohet me shkrim nga Sekretari i FGJK-se per skadim te afatit dhe obligimet e papaguara, duke i dhene edhe nje afat shtese prej 7 deri ne 15 dite per permbushjen e tyre. Ne rast se edhe pas ketij afati shtese obligimet nuk permbushen, pezullimi hyn ne fuqi automatikisht nga dita e skadimit te ketij afati. (është shtuar).
- Kreu III, Organet e federatës janë: - Kuvendi, - Kryetari, - Bordi Ekzekutiv, - Sekretari i përgjithshëm, - Këshilli Mbikqyrës, - Komisioni Disiplinor, Bordi i Apelit (mekanizëm për shqyrtimin e ankesave), (ndryshohet dhe emërohet - Komisioni i Ankesave), - Komisioni për përfaqësimin e sportisteve.
- Kreu III, Neni 14, paragrafi 4. ***Bordi Ekzekutiv vendos mbi pjesmarrjen e personave të tjerë në mbledhjen e Kuvendit. (largohet)***

  Kreu III, Neni 15, paragrafi 1.5. ***Zgjedh 3 anëtarët e Bordit të Apelit për një mandat katër (4) vjeçar, (largohet)***

  Kreu III, Neni 15, paragrafi 1.7. ***Zgjedh tre (3) anëtarë të Komisionit Disiplinor, një mandat katër (4) vjeçar, (bordi) (largohet)***
- Kreu III, neni 15, pargrafi 2. 2. Kuvendi i FGJK-së, ka të drejtën e miratimit dhe ndryshimit të Rregulloreve aktuale dhe Rregulloreve të reja të FGJK-së**:**
  1. Rregulloren e Punës së Kuvendit të Federatës Gjimnastikës së Kosovës,
  2. Rregullore e Këshillit Mbikqyrës të FGJK-së,
  3. Rregulloren e Bordit Ekzekutiv të FGJK-së (është ndryshuar),

  pasi që ishte:

  2. Kuvendi i FGJK-së, ka të drejtën e miratimit dhe ndryshimit të Rregulloreve aktuale dhe Rregulloreve të reja të FGJK-së**:**
  1. Rregulloren e Punës së Kuvendit të Federatës Gjimnastikës së Kosovës,
  2. Rregulloren mbi Punën e Bordit të Federatës së Gjimnastikës së Kosovës,
  3. Rregullore e Komisionit Disiplinor të FGJK-së,
  4. Rregullore e Këshillit Mbikqyrës të FGJK-së,
  5. Rregulloren e Reprezentacionit të FGJK-së, Ekipt Përfaqësues,
  6. Rregullore për Regjistrimin e Klubeve, Shoqatave Gjimnastikore, si dhe Transferet e Gjimnastëve/eve,

FGJK – KGF
Shtëpia e Sporteve, Rruga Agim Ramadani, 10000 Prishtinë, tel:044/145/009 email:
kosovagymnasticsfederation@gmail.com

7. Rregulloren Anti-Doping,
8. Rregulloren e Komisionit të Ankesave, (bordit të apelit).
9. Rregulloren për Përzgjedhjen e më të mirëve të FGJK-së,
10. Rregulloren Teknike për garat e FGJK-së,
11. Kodin Etik dhe të Sjelljes së Trainerëve të FGJK-së,
12. Rregulloren Kundër Ngacmimit dhe Abuzimit,
13. Formular per Regjistrim të Gjimnastëve/teve në FGJK dhe Klube.

Kreu III, Neni 16, paragrafi 5. Anëtarët (klubet, shoqatat) janë të detyruar që të sjellin emrat e personave të autorizuar për tu përfaqësuar me të drejtë vote në Kuvend, pranë Sekretariatit të FGJK jo më vonë se 7 ditë përpara datës së zhvillimit të Kuvendit. *Mospjesëmarrja në Kuvend i klubeve dhe shoqatave, sanksionohet me suspendim të klubit - shoqatës.* ***(largohet)***.

- Kreu III, Neni 18, paragrafi 1. Kuvendi i zakonshëm thirret nga Bordi Ekzekutiv jo më pak se një herë në vit. Njoftimi për Kuvend duhet t'u dërgohet anëtarëve (Ishte 20) bëhet 10 ditë përpara ditës së zhvillimit të saj.

Kreu III, Neni 20, paragrafi 1. Bordi Ekzekutiv mund të thërrasë një Kuvend të jashtëzakonshëm, pune apo edhe zgjedhor (shtohet) nëse mendohet se kjo është e domosdoshme.

- Kreu III, Neni 20, paragrafi 2. Kur të paktën 50% + 1 e delegatëve të Kuvendit të FGJK bëjnë kërkesë me shkrim, Bordi Ekzekutiv është e detyruar të thërrasë një Kuvend të Jashtëzakonshëm jo më vonë se 1 muaj pas marrjes së kërkesës. ***Nëse Kuvendi nuk mbahet, anëtarët që e kërkuan atë mund ta thërrasin mbledhjen vetë, duke ngarkuar një kryetar të përkohshëm me një grup pune. (largohet).***
- Kreu III, Neni 20, paragrafi 5. Bordi Ekzekutiv vendos për rendin e ditës. ***kur Kuvendin e thërret ai***. ***Kur ajo mbahet me kërkesën e 50%+1 të delegatëve, rendi i ditës duhet të përmbajë pikat e ngritura nga këta anëtarë. (largohet).***
- Kreu IV, Neni 23, paragrafi 2. Zgjedhja e kryetarit duhet të bëhet mbi bazën e (50%+1) të votave të delegatëve me të drejtë vote (shtuar) në raundin e parë, dhe nëse është vetëm një kandidat votimi bëhet me ngritje dore (aklamacion), nëse ka më shumë delegatë votohet me votim të fshehtë.
- Kreu IV, Neni 23, Paragrafi 3. Zgjedhja e anëtareve bëhet me shumicën e votave të delegatëve me të drejtë vote (shtuar) në mbledhje.
- Kreu IV, Neni 25, paragrafi k. Për shkarkimin e kryetarit, vendoset nëse me vota deklarohen mbi 50%+1 të numrit të delegatëve të me të drejtë vote (shtuar) në Kuvend.

Kreu IV, Neni 27, paragrafi 3. Kundër vendimit të Bordit Ekzekutiv mund të bëhet ankesë në Komisionin e ankesave (ndryshuar nga Bordi i Apelit ne Komision të Ankesave) në afatin prej tredhjetë (30) ditëve nga dita e dorëzimit të vendimit. Ankesa e paraqitur nuk e pezullon ekzekutimin e Vendimit.

Kreu IV, Neni 27, paragrafi 4. Komisioni i ankesave (ndryshuar nga Bordi i Apelit ne Komision të Ankesave) është i obliguar të zgjidh ankesën në afatin prej tridhjetë (30) ditëve.

Kreu V, neni 29, paragrafi 1.8. 1.8. Të miratoj rregulloret që hartoheën dhe përditësohen nga Komisioni për hartimin e rregulloreve:

1. Rregulloren mbi Punën e Bordit të Federatës së Gjimnastikës së Kosovës,
2. Rregullore e Komisionit Disiplinor të FGJK-së,

FGJK – KGF
Shtëpia e Sporteve, Rruga Agim Ramadani, 10000 Prishtinë, tel:044/145/009 email:
kosovagymnasticsfederation@gmail.com

3. Rregulloren e Reprezentacionit të FGJK-së, Ekipit Përfaqësues,
4. Rregullore për Regjistrimin e Klubeve, Shoqatave Gjimnastikore, si dhe Transferet e Gjimnastëve/eve,
5. Rregulloren Anti-Doping,
6. Rregulloren për Përzgjedhjen e më të mirëve të FGJK-së,
7. Rregulloren Teknike për garat e FGJK-së,
8. Kodin Etik dhe të Sjelljes së Trainerëve të FGJK-së,
9. Rregulloren Kundër Ngacmimit dhe Abuzimit,
10. Formular per Regjistrim të Gjimnastëve/teve në FGJK dhe Klube.
11. Rregulloren e Komisionit të Ankesave,
12. Dhe rregullore të reja. (Janë ri-pozicionu rregulloret janë në kompetencë të Bordit Ekzekutiv).

- Kreu VIII, Neni 39, Parafrafi 1.4. Bordi i Apelit (është ndryshuar më Komisionin e Ankesave).
- Kreu VIII, Neni 40, paragrafi 1.5. E drejta për të paraqitur ankesë në komisionin e ankesave (ka ndryshuar nga Bordi i Apelit në Komision të Ankesave)

  Kreu VIII, Neni 41, paragrafi 7. Nëse anëtari, të cilit i është ndërprerë mandati para skadimit të afatit për të cilin është zgjedhur, ka qenë anëtar i Komisionit Disiplinor, zgjedhet një anëtar i ri nga ana e Kryetarit të FGJK-së, mandati i të cilit zgjat deri në Kuvendin e radhës. (Ndryshohet: Nëse anëtari, të cilit i është ndërprerë mandati para skadimit të afatit për të cilin është zgjedhur, ka qenë anëtar i Komisionit Disiplinor, propozohet një anëtar i ri nga ana e Kryetarit të FGJK-së, dhe zgjedhet nga Bordi Ekzekutiv me 50%+1, të anëtarëve prezent.
- Kreu VIII, Neni 42, (ishte) Bordi i Apelit përbëhet nga tre (3) anëtarë të zgjedhur nga Kuvendi. Anëtarët referohet të kenë një arsimim juridik ose përvojë në çështjet juridike. 2. Vendimet e Bordit të Apelit janë përfundimtare për çdo ankesë që paraqitet ndaj organeve vendimmarrëse të FGJK-së.

  3. Një anëtar i Bordit të Apelit nuk mund të mbajë e as të marrë një pozicion në organet e tjera juridike të FGJK-së. 4. Bordit i Apelit vepron duke u bazuar në Rregulloren përkatëse të Bordit të Apelit. 5. Nëse anëtari, të cilit i është ndërprerë mandati para skadimit të afatit për të cilin është zgjedhur, ka qenë anëtar i Bordit të Apelit, zgjedhet një anëtar i ri nga ana e Kryetarit të FGJK-së, mandati i të cilit zgjat deri në Kuvendin e radhës.

  (ndryshon në KOMISIONI I ANKESAVE

  1. Komisioni i Ankesave përbëhet nga tre (3) anëtarë të zgjedhur nga Bordi Ekzekutiv. Anëtarët referohet të kenë një arsimim juridik ose përvojë në çështjet juridike. 2. Vendimet e Komisionit të Ankesave janë përfundimtare për çdo ankesë që paraqitet ndaj organeve vendimmarrëse të FGJK-së. 3. Një anëtar i Komisionit të Ankesave nuk mund të mbajë e as të marrë një pozicion në organet e tjera juridike të FGJK-së. 4. Komisioni i Ankesave vepron duke u bazuar në Rregulloren përkatëse të Komisionit të Ankesave). 5. Nëse anëtarit, të cilit i është ndërprerë mandati para skadimit të afatit për të cilin është zgjedhur, ka qenë anëtar i Komisionit të Ankesave propozohet një anëtar i ri nga ana e Kryetarit të FGJK-së dhe zgjedhet nga Bordi Ekzekutiv me 50%+1, të anëtarëve prezent.

FGJK – KGF
Shtëpia e Sporteve, Rruga Agim Ramadani, 10000 Prishtinë, tel:044/145/009 email:
kosovagymnasticsfederation@gmail.com

Kreu VIII, Neni 45, paragrafi 1, Nominimet e kandidimet për pozitat për: Kryetar, anëtarë të Bordit Ekzekutiv, Komisionit të Ankesave, (ndryshohet nga Bordi i Apelit në Komision të Ankesave) Këshillit Mbikqyrës, Komisionit të Garave, Komisionit Disiplinor, etj, mund të bëhen vetëm nga anëtarët e regjistruar në FGJK.

Këto janë ndryshimet e Statutit që janë spjeguar nga Sekretari i FGJK-së, mirëpo edhe përkundër spjegimit anëtarja e OMNISPORTIT insiston në shtyerje të pikave të rendit të ditës të statutit dhe rregulloreve të Kuvendit dhe Bordit, dhe të vazhdohet me pika tjera, pas konsultimeve, draft statuti i FGJK është kërkuar të votohet nga të pranishmit dhe 24 anëtarët prezent me të drejtë vote, votuan PËR, nuk kishtë kundër apo abstenime. Vlenë të ceket se pas aprovimit të ndryshimeve në Statutin e FGJK-së, dy anëtaret e OMNISPORTIT, edhe pas këshillave dhënë nga Kryetari Maqastena, Sekretari i FGJK-së, Tahiraga, zyrtari i MSR Z. Fatlum Grajqevci, dhe Zyrtari i KOK-ut, Z. Avni Nuha, ato lëshuan Kuvendin, duke cekur që nuk dëshirojnë të jenë pjesë e këtij lloj votimi pa ditur se për çfarë votojnë, sepse dokumentet duhet të jenë transparente, siç ceket edhe në statut dhe gjithashtu duke theksuar se të hënën do të dërgoj ankesë në ministri dhe se do të shihemi pas 1 muaji prap për punë të njejtë.

Me daljen e dy anëtareve të OMNISPORTIT nga Kuvendi, Sekretari i FGJK-së, kërkoj nga Komisioni i Verifikimit të numërojë anëtarët, dhe u konstatua se prezent në Kuvend ishin 24 anëtar me të drejtë vote dhe se Kuvendi mund të vazhdoj me punën e tij.

6. Propozim ndryshimi i Rregullorës së Kuvendit të FGJK-së dhe aprovimi i Rregullorës:

Sekretari njoftoj të pranishmit për ndryshimet në rregullore të Punës së Kuvendit

- Neni 8, KOURUMI DHE VENDIMMARRJA, Vendimmarrja për tu zgjedhur në cilëndo pozitë të organeve në Kuvend, për ndryshimet përkatëse në Statut si dhe shpërbërjen e FGJK-së përcaktohet në përputhje me nenin 14 paragrafin 2 dhe neni 15 nga paragrafi 1. deri tek paragrafi 1.15.dhe paragrafi 2 (është shtuar numri i paragrafëve), Nenin 21 paragrafi 1, si dhe neni 59, paragrafi 1, dhe 2, të Statutit.
- Neni 10, TË DREJTAT DHE PËRGJEGJËSITË E ANËTARËVE TË KUVENDIT,

Çdo anëtarë ka të drejtë të marrë pjesë në Kuvend apo të caktoj një përfaqësues në përputhje me nenin 17 paragrafi 1.1, dhe 1.6 (është shtuar) të Statutit. Pas spjegimit e rregullorja është votuar nga të pranishmit ku të gjithë anëtarët 24 prej tyre me të drejë votë votuan PËR, nuk kishte kundër apo abstenime.

7. Propozim ndryshimi i Rregullorës së Bordit të FGJK-së dhe aprovimi i Rregullorës:

Sekretari njoftoj të pranishmit për ndryshimet në rregullore të Punës së Bordit Ekzekutiv të FGJK-së.

- Në bazë të kreut III të Nenit 15 të Statutit të "Federatës së Gjimnastikës së Kosovës''

Kuvendi i FGJK-së, aprovoi këtë: (ndryshim), ishte Në bazë të kreut IV të Nenit 26 të Statutit të "Federatës së Gjimnastikës së Kosovës'' Kuvendi i FGJK-së, aprovoi këtë:

- VENDIMET DHE VOTIMI, Neni 22. Vendimet e Bordit miratohen me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm të Bordit 50% +1 (është shtuar) .

Neni 6, Bordi i FGJK-së në mbledhjet e veta nxjerr vendime, konkluzione, qëndrime, jep mendime, nis iniciativa dhe propozon zgjidhje të përshtatshme, aprovon rregulloret të reja dhe të përditësuara nga Komisioni për hartimin e rregulloreve, siç parashehet në statutin e FGJK-së, neni 29, paragrafi

FGJK – KGF
Shtëpia e Sporteve, Rruga Agim Ramadani, 10000 Prishtinë, tel:044/145/009 email:
kosovagymnasticsfederation@gmail.com

1.8. (është shtuar). Pas spjegimit rregullorja është votuar ku të gjithë anëtarët votuan PËR nuk kishte kundër apo abstenime.

8. Raporti Narrativ për vitin 2025 dhe aprovimi i tij: Raporti narrativ i është dërguar më kohë të gjithëve dhe pasi që nuk kemi pranuar ndonjë koment, i njejti vendoset të votohet ku të gjithë të pranishmit 24 prej tyre me të drejtë vote, votuan PËR, nuk kishte kundër apo abstenime.

9. Raportet financiar, të FGJK-së, për vitin 2025 dhe aprovimi i tyre: Edhe në këtë pikë të rendit të ditës nuk pati komente dhe raportet janë votuar ku të gjithë të pranishmit votuan PËR, nuk kishte kundër apo abstenime.

10. Aprovimi i Planit të Aktiviteteve dhe Buxhetit të FGJK-së për vitin 2026: Në këtë pikë Sekretari spjegoi që është forma e re për planin e aktiviteteve dhe buxhetore, dërguar nga MSR, i cili është i paraqitur bazuar në pikët ë kategorizimit, Plani i Aktiviteteve dhe Buxheti u votuan nga të pranishmit të gjithë ishin PËR nuk kishte kundër apo abstenime.

11. Pranimi i Klubeve të reja në FGJK: Sekretari njoftoj të pranishmit për kërkesën e bërë në FGJK të klubit të gjimnastikës Ritmike "RITMIKS" nga Ferizaji, komisioni ka kontrolluar të gjitha dokumentet e kërkuara nga FGJK, dhe ka dërguar raportin tek Bordi Ekzekutiv i FGJK pas konstatimit se janë përmushur të gjitha kriteret e vendosura siç parashihen në legjislaturën e FGJK-së. Bordi Ekzekutiv i FGJK ka dërguar rekomandimet në Kuvend për pranimin e këtij klubi pasi që i ka plotësuar të gjitha kushtet. Kryetari informon anëtarët e Kuvendit për punën e këtij klubi dhe të arriturat e tij dhe trajnerit të klubit. Pas marrjes së informacioneve të gjithë anëtarët prezent në Kuvend, 24 me të drejtë votë votuan PËR pranimin e Klubit në FGJK, andaj me datë 18/04/2026, Klubi i Gjimnastikës Ritmike "RITMIKS" është pranuar në FGJK, mirëpo duhet të licensohet edhe nga MSR dhe pastaj të këtë të drejtën e votës në Kuvend të ardhshëm. Fjalë rasti i është dhënë përfaqësuesës së Klubit, Fiona Konxhelit e cila falendëroj anëtarët e Kuvendit të FGJK-së për pranimin e klubit të saj dhe se beson në bashkëpunim të mirë me FGJK.

12. Diskutimi për veglat gjimnastikore, (baby gym) nëpër klube: Anëtarëve të Kuvendit të FGJK-së, i është dhënë një dokument për të vendosur për çfarë vegla gjimnastikore kanë nevoj, dhe është spjegu nga Kryetari se FGJK është duke bërë përpjekje që të gjëj donacion për vegla gjimnastikore dhe është në kontakt me Federata të ndryshme ndërkombëtare për këtë gjë, deri me tani kemi premtime se Federata e Gjimnastikës e Turqisë do të ndihmojë FGJK.

Të gjithë anëtarët plotësuan këtë dokument, dhe bazu në këtë FGJK do të ketë më të kjartë se për çfarë vegla kanë nevoj Klubet.

13. Të ndryshme: Anëtari Fatlind Qerimi nga Klubi i Gjimnastikës Fushë Kosovë i beri pyetje kryetarit Shkumbin Maqastena për interesimin se sa kanë avansuar punimet e sallës së gjimnastikës në komunën e Fushë Kosovës, ndërsa nënkryetarja Sherife Aliçkaj Qerimi dha një informacion se

FGJK – KGF
Shtëpia e Sporteve, Rruga Agim Ramadani, 10000 Prishtinë, tel:044/145/009 email:
kosovagymnasticsfederation@gmail.com

kryetari i komunës së Skenderajt ka dhanë mundësinë e ndarjes së një parcele në qendër të kësaj komune për ndërtimin e një salle të Gjimnastikës me standardet e fundit.
Gjithashtu përfaqësuesi nga Klubi i Gjimanstikës Ritmike "RITMIKS", falenderoj të pranishmit për pranimin e klubit në FGJK, si dhe kërkoj që të ndihmohet me vegël gjimnastikore "parter" për gjimnastikë ritmike. Kryetari Z. Maqastena pëgjigjet duke thënë se do mundohemi të gjejmë zgjidhje për këtë qështje përmes donacioneve ose menyrë tjetër.

KONKLUZION: FGJK konkludon se i tërë procesi i Kuvendit të Punës i FGJK-së, ishte në rregull, pavarësisht kritikave dhe mospajtimeve nga ana e anëtarëve të OMNISPORTIT, të gjitha pikët e rendit të ditës janë aprovuar nga 24 anëtar të Kuvendit më të drejtë vote.

Pas mbledhjes së Kuvendit të FGJK-së, nga Sekretari i FGJK-së, u përgadit raporti për Ministrinë e Sportit dhe Rinisë - Departament të Sporteve dhe Komitet Olimpik të Kosovës.

Të bashkangjitura i gjeni:
1. Fotot e bëra gjatë Kuvendit të Punës dhe Zgjedhor të FGJK-së, 18/04/2026,

FGJK – KGF
Shtëpia e Sporteve, Rruga Agim Ramadani, 10000 Prishtinë, tel:044/145/009 email:
kosovagymnasticsfederation@gmail.com

KUVENDI I PUNËS I FEDERATËS SË GJIMNASTIKËS TË KOSOVËS

PROCEVERBALI



FGJK – KGF
Shtëpia e Sporteve, Rruga Agim Ramadani, 10000 Prishtinë, tel:044/145/009 email:
kosovagymnasticsfederation@gmail.com

KUVENDI I PUNËS I FEDERATËS SË GJIMNASTIKËS TË KOSOVËS

PROCEVERBALI



FGJK – KGF
Shtëpia e Sporteve, Rruga Agim Ramadani, 10000 Prishtinë, tel:044/145/009 email:
kosovagymnasticsfederation@gmail.com

KUVENDI I PUNËS I FEDERATËS SË GJIMNASTIKËS TË KOSOVËS

PROCEVERBALI



FGJK – KGF
Shtëpia e Sporteve, Rruga Agim Ramadani, 10000 Prishtinë, tel:044/145/009 email:
kosovagymnasticsfederation@gmail.com

KUVENDI I PUNËS I FEDERATËS SË GJIMNASTIKËS TË KOSOVËS

PROCEVERBALI



Mbledhja e Kuvendit të Punë të Federatës së Gjimnastikës së Kosovës përfundoi në ora 14:00, të datës 18/04/2026.

Procesmbatësi:
Elfete Gashi

Proces verbali është vërtetua nga Sekretari i Përgjithshëm i FGJK-së
Amir Tahiraga

FGJK – KGF
Shtëpia e Sporteve, Rruga Agim Ramadani, 10000 Prishtinë, tel:044/145/009 email:
kosovagymnasticsfederation@gmail.com